

**KONTRATE
DHURIM KUOTASH KAPITALI
SHOQERIA "DRAGO" SHPK**

Sot më datë 01.10.2015, ne palet kontraktuese si me poshtë:

AKSIONERI: Juela Mesi, e bija e Elton, e datëlindjes 13.12.1994, e identifikuar me ID Nr. 031715692 dhe numër personal J46213014U, lindur ne Nikel - Kruje dhe banues ne Nikel - Kruje, ortake e shoqërisë "Drago" shpk e regjistruar ne QKR me 25.09.2006, me Nipt K73919201E, madhore dhe me zotesi te plote juridike per te vepruar, ketu e me poshte do te quhet **Dhuruesi**.

DHE

AKSIONERI: Erind Kosova, i biri i Bajramit, i date lindjes 30.04.1982, me leter njoftimi I20430059D, lindur ne Tirane dhe banues ne Tirane, madhore dhe me zotesi te plote juridike per te vepruar, i cili ketu e me poshte do te quhet **Përfituesi**.

Baza Ligjore:

- Neni 761 e vijues i Kodi Civili Rep Shqiperise;
- neni 73, pika 1, germa ç dhe pika 2, i Ligjit Nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqërit Tregtare";
- Ligji Nr 9723, date 03.05.2007 "Per Qendren Kombetare te rregjistrimit";

Palet bien dakort te perpilojne kete kontratë dhurimi të kuotave të kapitalit, në Shoqërinë "Drago" shpk, si me poshte:

1. Dhuruesi **Juela Mesi**, me gjeneralitet e mesiperme, është pronar i 70% te kuotave te kapitalit ne shoqerine "Drago" shpk, te regjistruar ne QKR me Nipt K73919201E, në bazë të vendimit të ortakëve të shoqërisë nr.1, date 01.10.2015, vendosi me vullnetin e lirë dhe të plotë, t'i dhuroj totalisht dhe pa kushte përfituesit, ortakut tjetër të shoqërisë, Erind Bajram Kosova, 70 % të kuotave të kapitalit, ose numri i aksioneve 24.990, me vlere totale 24.990.000 lekë, të cilat i zotëroja në shoqëri deri në këto momente dhe për të cilat unë nuk kam më asnjë të drejtë mbi këto kuota të dhuruara.
2. Përfituesi **Erind Kosova**, pranon dhurimin e kuotave te identifikuar ne paragrafin 1 te kesaj kontrate, eshte dakord me ketë dhurim dhe e pranon dhurimin e mesipërm, si edhe ka shprehur vullnetin e tij per perfitimin e 24.990 kuotave, ose përqindja në kapital 70, qe dhuruesi zoteron ne kete shoqeri ose Kontributi ne para 24.990.000 lekë. Pas nenshkrimit të kësaj kontrate bëhet pronar i 100% të kuotave të kapitalit në shoqërinë "Drago" shpk.

Juela Mesi
Erind Kosova



REPUBLIKA E SHQIPERISE
ERIND KOSOVA
KOSOVA



Pas nënshkrimit të kësaj kontrate, kapitali themeltar i shoqërisë është i përbërë nga shuma prej **35.700.000** lekë, shumë e percaktuar në bazë të vullnetit të Ortakut të vetëm të shoqërisë.

3. Dhuruesi deklaron dhe garanton Perfituesin sa me poshte:

- a) Shoqëria është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e organizuar dhe e themeluar rregullisht në përputhje me legjislacionin e Republikës së Shqipërisë dhe e regjistruar në të gjitha autoritetet shtetërore në përputhje me kërkesat e ligjit.
- b) Në ditën në të cilën nënshkruhet kjo kontratë, kapitali themeltar i Shoqërisë është **35.700.000 lekë** i ndarë në **35.700 kuota**, me vlerë të aksionit **1.000,00**. Dhuruesi ka të drejta të plota pronarie mbi kuotat dhe zoteron çdo interes përfitues mbi të gjitha Kuotat ekzistuese.
- c) Objekti i kësaj kontrate dhurimi është i lire nga çdo barre siguroese, garanci apo peng.
- d) Dhuruesi deklaron se shoqëria nuk ka shkelur asnjë ligj në fuqi dhe nuk është duke vepruar në kundërshtim me to. Të gjitha deklaratat tatimore dhe raportet e shoqërisë sipas Ligjit janë depozituar, dhe se të gjitha njoftimet vlersimet tatimore, tarifatat dhe çdo pagese tjetër shtetërore e detyrueshme për shoqërinë, mbi asetet apo të ardhurat e saj të cilat janë të pagueshme, janë paguar.
- e) Dhuruesi deklaron se shoqëria nuk ka detyrime të papermbushura lidhur me marrveshjet apo detyrimet në të cilat është pale, apo sipas të cilave ajo apo pasuritë ose asetet e saj janë kufizuar dhe se nuk ekziston asnjë shkak mospermbushje, apo në dijeninë me të mirë të Dhuruesit, apo ndonjë shkak i mundshëm për mospermbushje apo në dijeninë me të mirë të Dhuruesit ndonjë shkak i mundshëm për mosperputhjet sipas ketyre marrveshjeve, shoqëria nuk është pale si dhe nuk është në dijeninë të ndonjë konflikti gjyqësor, arbitrazhi apo procedimi administrativ, rezultatit i të cilit mund të ketë efekte negative mbi dhurimin, aktivitetin e përmbushur detyrimet e saj sipas marrveshjeve në të cilat është pale.
- f) Dhuruesi deklaron dhe garanton Perfituesin se nuk do të ketë asnjë përgjegjësi nga pretendimet që mund të lindin kundër Shoqërisë në lidhje me aktivitetin e zhvilluar prej saj përpara nënshkrimit të kësaj kontrate.
- g) Me nënshkrimin e kësaj Kontrate nga palet e mesipërme, aksionet do të jenë prone e Perfituesit dhe do të jete detyrim i vlefshëm dhe ligjor për Dhuruesin, i ekzekutueshëm në përputhje me kushtet e parashikura në të.
- h) Me nënshkrimin e kësaj kontrate kapitali i Perfituesit në shoqërinë "Drago" Sh.p.k nga **10.710.000** leke i barabart me **10.710** kuota ose **30 %**, bëhet **35.700.000** leke i barabart me **35.700** kuota ose **100 %** të totalit të aksioneve të shoqërisë "Drago" Sh.p.k.

4. Perfituesi deklaron dhe garanton Dhuruesin sa me poshte:

- a) Kjo kontratë përben një detyrim të vlefshëm dhe ligjor për Perfituesin, përmbushja e të cilit nuk do të konsiderohet si shkelje e ndonjë dispozite apo të ndonjë marrveshje vendase dhe nderkombtare të cilat aplikohen ndaj tij.
- b) Në rast dhurimi nga ana e përfituesit të ketyre aksioneve të përfituara nepermjet kësaj kontrate, përfituesi mund të dhurojë serish keto aksione dhuruesit të kësaj kontrate.
- c) Data e Transferimit të pronësisë do të jete data e nënshkrimit të kësaj kontrate, në këtë datë Perfituesi do të konsiderohet si pronari i 100% të Kuotave të Dhuruesit ndërsa Dhuruesi nuk do të zotërojë me asnjë kuotë në shoqëri.

Ortaku i ri i vetëm i shoqërisë është:

Jueta
Mer
Jueta



REPUBLIKA E SHQIPËRISE
ERIND KOSOVA
KOSOVA
ALBANIA



Erind Kosova , i biri i Bajramit i date lindjes 30.04.1982 me leter njoftimi I20430059D, lindur ne Tirane dhe banues ne Tirane, i cili behet zotrues i 100% te kuotave ose 35.700 kuota me vlere 35.700.000 leke.

Objekti veprimtarise se shoqerise nuk ndryshon por ortaku do te hartojte statutin e ri te shoqerise, me qellim saktesimin e detyrimeve midis Ortakut te vetem.

Selia e shoqerise:



Selia kryesore e shoqerise do te qendroj Komunen Nikel – Qender, Rrethi Kruje, qarku Durres.

Dispozita te fundit

Kjo kontrate per transferimin kuotave te kapitalit te shoqerise hartohet ne 3 kopje te barabarta dhe nenshkruset rregullisht nga palet.

DHURUESI

Juela Mesi

Juela Mesi



PËRFITUESI

Erind Kosova

Erind Kosova

